

KAÇANIKU PËRSËRI HYRI NË HISTORI

● Atë ditë, në këtë qytet, u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës, realizimi i të cilës vazhdon të jetë synim historik i të gjithë shqiptarëve ● — Mbi atmosferën dhe misionin që ëndërron ta përjetojë çdo gazetar

Nuk më kujtohen ditët e tjera të shtatorit të vjetshëm, por Shtatorit i vitit 1990 i di se ka qenë një ditë e bukur, e kthjellët, plotë dritë e diell, tamam përgjigjet që do të ndodhët atë ditë në një cep të Kosovës, që do të mbetet në histori përgjithmonë dhe ajo tanë i takon asaj me tërë madhështinë që ngërthen. Për gazetarët, raportimi nga ngjarje të tillë përit me dekada. Shumë vdesin dhe nuk u bie hise një ndër i tillë. Unë qesh i ndeuar. Isha i vërtë dëshmitar gazetar i shpaljes së Kosovës Republikë nga Parlamenti i saj, nga përfaqësuesit e popullit.

Si sot, para një viti, sekretari i Komisionit Kushtetues të Kosovës, Halil Muhamremi, më njoftoi se në orën 20, ne Kaçanik, në Shtëpinë e Kulturës do të mbahet një mbledhje me rëndësi e Kuvendit të Kosovës. Ishte e premja e parë e shtatorit. Më tha që, mundësish, ta merrja me veturnë edhe delegatet Afijet, të cilët e kisha fjinje. Në redaksinë e «Rilindjes», tashmë një muaj të ndaluar, redaktorët më thanë se nuk ishtë asnjë fotoreporter i saj. E fitova fotoreporterin e Redaksisë së Revistave (Këshilli e quajmë ndërmarrjen gazetare-botuese që përfshin një gjum i saj «Fjalën», «Shkëndijen», «Kosovaren», «Thumbin», «Pionierin», Gazetën e pionierëve...). Enver Bylykbashin, i cili në stilin e profesionistëve, që kësaj zejeje i janë përkushtuar me gjithë qenien, më tha se ishte gati kur unë të isha gati. U takuan rrëthi orës 18 para Qendrës së Studentëve, ku kanë nisur thuaqje të gjitha ngjarjet historike të shqiptarëve të Kosovës vjetët e fundit. Fare nuk më pyeti ku duhej të shkonim. I thashë se ngjarja ishte e rëndësishme, se duhej të ishte i përgatitur. Isha i siguri se më përgjiohej telefoni dhe kisha kujdes që të mos e them se përfshirë ngjarje ishte fjalë. Rrugës (në disa pompa benzine) kërkoi bateri, por ato i gjeti vetëm në Kaçanik.

E pyes Afijeten, a kishte frikë.

— Jo, fare. Do t'i qësim punë politisë, që na ndjek në çdo hap, — tha ajo duke qeshur, edhe pse puna nuk ishte pa rezik. Shtëpia e Kulturës në Kaçanik nuk është larg stacionit të politisë. Kaçaniku, pastaj, nuk është ndonjë qytet i madh sa të mos vërehen myshafit. Por, ata që ishin marrë me përgatitjen e mbledhjes ishin kujdesur për të gjitha. Delegatët duhej të arrinë në mes orës 19 e 20. Të parët duhej të vinin ata nga komunitat fjinje, sepse veturnat me targat e këtyre qyteteve ishin të zakonshme dhe nuk do të binin në



Delegatët e Kuvendit Kosovar në mbledhjen historike në Kaçanik, më 7 shtator 1990, kur Kosovët e shpallën Republikë

sy. Ata nga Gjakova, Peja, Prizreni e Mitrovica duhej të vinin pak para orës 20.

Si mua, me siguri edhe delegatëve, u ishin dhënë parullat e identifikimit. Pasi të kalonin udhëkryqin që kthen në Brezovicë,

nëse do të shihnim ndonjë kamion të ndalur, me ndonjë çarshaf të bardhë, duhej ta pyesim: «Të duhet ndihma» Ai pastaj do të trengonte për ndërrimin eventual të vendit ku do të mbahet mbledhja, (Faqe 2)

REPUBLIKA DOLI NGA ZEMRA E POPULLIT

Sot kur përkujtojmë shtatë shtatorin e viti të kaluar, atëherë kur në Kaçanik u shpall e aprovar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, domosdø i imponohet shpalimi i efekteve die i të arritura në dobi të zgjdhjes së çështjes shqiptare, por edhe mendimi se a kemi mundur të bëjmë më shumë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dolë nga zemra e popullit dhe si rezultat i përpjekjeve shumëvjeçare të tij për të pasur shitet dhe pushtet të organizuar nga vet populli dha barazi si të gjithë të gjërit këtu në Jugosllavi dhe më gjérë në Ballkan dhe në Evropë. Kjo dëshirë e popullit, se pakut në aspektin formal juridik-kushtetueshështë jetësuar me Deklaratën kushtetuese të 2 Korrikut për mvehtësi dhe barazi të subjektit të Kosovës me subjektet e tjera në Jugosllavini konfederative, apo federative dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dolë në kohë të mirë. Atëherë, përkujtojmë, ishte e qartë se Jugosllavia po shkapërdheret, se shumica e kombeve shtetërmuese të Jugosllavisë, duke e parë qartazi rrëzikan nga kjo shpërberje edhe nga hegemonizmi dhe kolonializmi serbomadhi, shpejtuan të përgatintin dhe të miratonin kushtetut e mvehtësishështë dështë sovranitetit republikan (Slovenia, Kroatia, tash Maqedonia dhe Bosna e Hercegovina) dhe aktet e tjera përcjellëse, madje edhe ato që garantojnë shkëputje. Kreuzku më i madh nga ky hegemonizmi dhe nga ky kolonializmi i formës më të re të politikës serbomadhe më shumti, si përhershë më parë, i kanosë popullit shqiptar dhe Kosovës. Akti i Kaçanikut këshu i edhe si akt i vëmbrojtjes nga kthethet e politikës së tashme zyrtare serbe.

Ashkush nuk ka pritur se pas këtij akti gjithçka do të zhvillohet në të mirë të jetësimit i tij praktik. Se, dhuna e pushtetit serb që nuk u zgjedhura, por ajo u shua. Në fakt, ligjet reprezive të Kuvendit të Serbisë, të cilat ishin në veprim shumë më heret dhe të cilat shumë më heret ishin përgatitur për të rrënëtar têrë atë që kishte mbetur nga autonomia e cunguar e Kosovës, pas 2 Korrikut dhe shtate shtatorit, edhe me ndihmën e forcave shtuara të ushtrisë dhe të policisë serbe, ushtruan pushtet të dhunës mbi të gjitha organet e administratës, të arsimit, shken-

cës, shëndetësia, kulturës, informimit dhe mbi ato të ekonomisë së Kosovës.

Në anën tjetër, së bashku edhe me partitë politike të Kosovës, me ndihmën e gjithë shqiptarëve kudo që u gjenden në botë, e vëratë për shpyjen dhe dhunimin e drejtave dhe lirive qytare e njerëzore të shqiptarëve, pikërisht edhe në mungesë të zgjdhjes së drejtë të çështjes së statusit të Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi, arriti të depërtojë në shkallën e më të lartë kudo në botë. Dhe, rezultat i këtij afirmimi të çështjes shqiptare në botë do të shumë angazhimë të qeverive të shtetave botërore, të institucioneve dhe të veprimtarëve ndërkombëtarë në të mirë të zgjdhjes dhe vendosje së drejtë edhe për vuillnин e popullit shqiptar në Jugosllavi. Kontributi i delegatëve dhe i anëtarëve të mbetur të angazhuar të Qeverisë së Kosovës edhe kështë i shumë i patë.

Edhe me këtë rast përvjetori, por, imponohet edhe mendimi se a është bërë e tërë ajo që ka pasur mundësi të bëhet? Se, a është dashati të veprohet dëshjetë kështu, apo ashtu? Në kushtetutë e rrethanat e okupimit të Kosovës, në rrethanat e iutës në Jugosllavi, dhe të shkaperdherjës së saj, në rrethanat kuri pritej që në rastin ligjive kushtetuese të Serbisë e intervenoje Kuvendi i Jugosllavisë, Gjykata kushtetuese e Jugosllavisë, apo institucionet e tjera të drejtës ndërkombëtare, ishte në fillim e mijëgulluar se cili potë do të ishte më efikas dhe politikisht më i qëlluar. Atëherë shtrohë problemi i zgjedhjeve të lirë edhe në Kosovë, i pjesëmarrjes, apo i mospjesëmarrjes së shqiptarëve në to, shtrohë edhe problemi i regjistrimit të partive politike të Kosovës, etj, por, ashtu si e pranojë sot edhe vet disa delegatë të Kuvendit të Kosovës, gjithsesi edhe këta kanë mundur të bëjnë pune më efikase në radhë të parë me vtororganizim, me zgjdhjen e çështjes së grupeve, komisioneve, e deri te qeveria e reformar, në të mirë të veprimt më efikas.

Po, janë edhe të kuptueshme të gjitha rrethanat në të cilat punojnë dhe veprojnë këta delegatë dhe qeveria e përgjysmuar e Kosovës.

KONFERENCË SHTYPI NË LIDHJEN DEMOKRATIKE TË KOSOVËS

MARRËVESHJET EVROPIANE PA SHQIPTARËT – NUK VLEJNË

● Shqiptarët sot nuk kanë kurfurë arsyewe që armatën ta kuptojnë si armatë të veton dhe të shkojnë në një armatë të tillë.

— Nuk do të lejojmë që, sa i përket arsimt, të politizohen fëmijët tanë. — Me çdo kusht do ta mbrojmë identitetin e shqiptarëve dhe të Kosovës. — Bashkësia e ardhshme jugosllave nuk mund të jetë bashkësi e slavëve të Jugut, sepse edhe ne shqiptarët jemi këtu. — Nuk do të ketë sukses i përfundim i përzullimit të Kosovës. — Nuk është e sigurt se mësimi do të fillojë më 1 tetor. (Faqe 5)

SOT, NË HAGË

FILLON KONFERENCA PAQËSORE PËR JUGOSLLAVINË

● Përfaqësuesi i delegacionit holandez pohoi se ardhjen e konfirmuan të gjithë pjesëmarrësit e Jugosllavisë

Konferencia për Jugosllavinë do të fillojë nësër paratë në Hagë, sic është vendosur para tre ditësh në takimin e ministrave të Punave të Jashtës të BE-së kryeqytetin e Holandës. Këshitu u kumofat si gazetarëve zhëndësish në delegacionit holandez, gjatë takimit të shefave të diplomacisë të Dymbëdhjetës, që po zhvillohet në Bruksel. Ai tha po ashtu se të gjithë pjesëmarrësit e Jugosllavisë kane konfirmuar ardhjen në hapjen e Konferencës. (Tanjug)

UZINË
PËR PJEKJEN
DHE BLUARJEN
E KAFESË

Kafja e pjetur është nga illojet më të njohura të kafe-jugamerike dho ajo afrikane. Pjetur bëhet me makinë me bashkëkohore elektronike të cilat sigurojnë AROMË dhe CILËSI të përkryer. Furnizimi me shumicë e pakicë mund ta bëni drejtësuar nga uzinë, rr. «Vellusha e Epërme» nr. 5/papë TPK/t, tel. fax: 038/24-648

NHTT «shpati commerce»
PRISHTINË

JU OFRON

- SHËRBIME HOTELIERE
 - SHËRBIME TURISTIKE
 - SHËRBIME TREGTARE
 - SHËRBIME NDËRMJETËSUËSE
- Informatat në tel. 038/24-973



AUTOTEKNIK
NOMINARIA TREGTARE ME SHUMICË DHE PAKE
EXPORT-IMPORT

SHET KËTO VETURA DHE
PJESE TË NDËRRIMIT

38000 PRISHTINË, rr. M. Titën, nr. 28
Tel. 038/24-154, Fax 038/24-177



N.T.H. RESTORANTI
POREČ
N.J.S. PUNUESH - POREČ 1
OREKS TË MIRE

